



TË DHËNAT PËR ASETIN

Shitja e Aseteve përmes Likuidimit Nr.73

Njësia e Vendosur në Tender Nr.86

NSH DLB-Parcela 9721-0-ZK Prizren

Emri i NSh.-së	NSH "D.L.B Lavërtaria-Blegtoria" - Prizren në likuidim ("Ndërmarrja") (emrat e mëparshëm): PIK "Progres-Export"- "Ratarstvo" sa P.O Dusanovo, "Progres Export- Ratarstvo i Stocarstvo " Fi.-698/89, Fi.-7337/92).
Lloji i Shitjes	Shitje përmes Likuidimit me ofertë të mbyllur
Dita e Ofertimit	25.06.2025 nga ora 10:00h deri 12:00h në Sallën e Konferencave të "HOTEL GRAND" në Prishtinë
Çmimi Minimal	20,000 €/ari
Depozita e Ofertës	35,000 €
Kategoria potenciale për shfrytëzim	Komerciale
<u>Përshkrimi i Aseteve</u>	
Vendndodhja e Aseteve	<p>Zona Kadastrale Prizren, Komuna e Prizrenit</p> <p>Të dhënat e hartës ©2025 Google</p> <p>Shikoni këtë pronë në Google Maps</p> <p>Aktmohim: Vendndodhjet e treguara nga PIN-at në Google Maps ofrohen vetëm për qëllime të orientimit dhe referencës së përgjithshme. Këto mund të mos pasqyrojnë saktësisht vendndodhjen, kufijtë ose veçori të tjera të asetëve të përshkruara. Përdoruesit këshillohen të verifikojnë në mënyrë të pavarur të gjitha vendndodhjet për çdo çështje që kërkon saktësi ose informacion me rëndësi ligjore.</p>
Ndërtesat dhe tokat	<p>NSH DLB - Parcela 9721-0 - ZK Prizren - ofron për shitje tokën bujqësore që ndodhet në Zonën Kadastrale Prizren dhe përfshin ngastrën kadastrale P-71813068-09721-0 me sipërfaqe prej 3450 m² (arë kl.3) e regjistruar në emër të NSh-së në Certifikatën për të Drejtat Pronësore të Pasurisë së Paluajtshme. Nga vizita në terren dhe analiza e të dhënave kadastrale mund të konstatojmë:</p> <ul style="list-style-type: none">Parcela shtrihet në zonën urbane dhe është e rrethuar me parcela në të cilat ekzistojnë ndërtime/ shtëpi të banimit individual dhe objekte afariste.Sipërfaqja e parcelës kadastrale sipas kufijve kadastral është 3445m², ndërsa sipas certifikatës pronësore është 3450m², dallimi i konstatuar është minus 5m² përderisa ai i lejuar është plus/minus 59m².Parcela është e shtruar me zhavorr dhe shfrytëzohet aktualisht si vend parkim për autobusë nga biznesi "Fidani Tours" si dhe vend parkim për automjete të vogla.Parcela ka qasje në rrugën Prizren-Zhur. <p>Nuk ka ndërtesë në këtë shitje.</p>



	<p>Vërejtje për pronën për ofertuesit e mundshëm:</p> <p>Në pronën lëndë e shitjes, në Certifikatën e Pronës së paluajtshme nuk ka të regjistruar barrë tatimore.</p> <p>Në kërkesën e AKP ZR Prizren lidhur me informatën për barrë tatimore (kërkesave të ZR Prizren) ATK është përgjigjur me shkresën e datës 19.01.2017, 24.01.2017, 15.09.2017 dhe 22.11.2018 se NSH-ja ka të vendosur barrë tatimore që nga data 03.12.2013. Në përgjigjen e datës 24.01.2017 nga ZQ ATK Prishtine, përveç informative për barre tatimore të vendosur është bashkangjitur edhe Konkluzioni nga ZKK Prizren i dt. 10.02.2014 përmes së cilës kërkohet nga ATK-ja që barra të vendosur tatimore në prone të DLB-se, të pezullohet përkohësisht. Gjithashtu, me dt.02.03.2017 është dërguar kërkesa në ATK-Prishtine për rishqyrtim të barrës tatimore të vendosur në pronën e NSH-se, dhe me dt. 13.03.2017 është pranuar përgjigjja nga ATK-ja ku ceket se vendosja e barrës tatimore është bërë me 03.12.2013 para fillimit të likuidimit të NSH-se në fjale dhe se nuk është në kundërshtim me Ligjin 03/L-222, Udhëzimi administrative 2010/15 dhe Memorandumit në mes ATK dhe AKP.</p> <p>AKP ZR Prizren, nuk është njoftuar zyrtarisht nga ana e ATK-së as nga ana e ZKK-se mbi vendosjen respektivisht pezullimin e përkohshëm të barrës tatimore ndaj tërë pronës së NSH DLB Lavërtari Blegtori. Me 05.11.2018 është ri-dërguar kërkesa për regjistrim të barrës tatimore dhe me 22.11.2018 është pranuar përgjigjja nga ATK-ja se NSH-ja ka të vendosur barrë tatimore që nga data 03.12.2013. Me 03.04.2025 është dërguar kërkesa në ATK nëse NSH-ja ka të regjistruar barrë tatimore, dhe me datë 14.04.2025 është pranuar përgjigjja nga ATK se NSH-ja ka të vendosur barrë tatimore.</p>
Shfrytëzuesit	Nuk ka.
Asetet tjera	Nuk ka.
Detyrimet që do të barten	Asnjë nga detyrimet nuk do të barten tek blerësi i ri, por sidoqoftë blerësi potencial duhet të ketë parasysh se mund të jetë i aplikueshëm tatimi për bartjen e pronës.



FILIM / KËRKO DHE PARAQIT /

Kërko | Rezultati i kërkimit

Shfaq Zgjedhur Rezultatet Shtato

P. Cadastre/Unitid C. C. S. Spërfaqja Grafike

1. P-71813068-09721-0 7. 7. 1 3445.1

Vendos në objekt Zmadho në objekt

Numri i rezultateve: 1 (showing first 1)
Nga hartat: 0

Detajet

CadastreZoneCode: 71813068
Geometry:
Status: 1
Spërfaqja Grafike (m²): 3445.1

Raport

Scale = 1:1000

Pozita: 7473277.657, 4673286.400

Foto/fotot
ose informata të tjera
për asetet në shitje

Fig.1 Parcela kadastrale nr.9721-0, ZK Prizren; <http://geoportal.rks-gov.net/>

Informatat rreth Njësisë lëndë e shitjes të prezantuar në Te Dhëna nuk janë të garantuara. Investitorët potencial inkurajohen të kontaktojnë Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP) për të kërkuar dokumentet e tenderit. Ata të cilët dëshirojnë të paraqesin ofertë duhet të llogarisin në hulumtimet e tyre. Investitorët potencial këshillohen të bëjnë verifikimin e të dhënave vet para se të paraqesin ndonjë ofertë ose propozim për tender. Këto të Dhëna janë në dispozicion nën kushtet e përgjithshme në informatat paraprake për informacione të publikut të gjerë për kandidatët e privatizimit, e cila mund të nxirret nga faqja e internetit të AKP-së: www.pak-ks.org.



01/04/2025

Raport nga vizita në terren - D.L.B Lavërtari Blegtori – Parcela nr. 9721-0, ZK Prizren

Më datën 01/04/2025, është kryer vizita në terren me qëllim të identifikimit dhe konstatimit të gjendjes faktike për parcelën kadastrale nr. P-71813068-09721-0, ZK Prizren, Komuna Prizren e cila është e regjistruar në posedim individual të PIK Progres.

Në bazë të "Raport nga AKK", shkarkuar nga "Shërbimi Digjital i AKK-së", dt. 01/04/2025, konstatohet se njësi kadastrale e llojit "parcelë" me nr. identifikues P-71813068-09721-0, me sipërfaqe 3450m², vendi i quajtur "Prizren", lloji i shfrytëzimit "bujqësore", shfrytëzimi aktual "arë e klasës 3", ZK Prizren, Komuna Prizren, është e regjistruar në posedim individual të PIK Progres.



Fig.1 Parcela kadastrale nr.9721-0, ZK Prizren; <http://ecportal.rks-gov.net/>

Nga vizita në terren dhe analiza e të dhënave kadastrale mund të konstatohet:

- Parcela shtrihet në zonën urbane dhe është e rrethuar me parcela në të cilat ekzistojnë ndërtime/shtëpi të banimit individual dhe objekte afariste.
- Sipërfaqja e parcelës kadastrale sipas kufijve kadastral është 3445m², ndërsa sipas certifikatës pronësore është 3450m², dallimi i konstatuar është minus 5m² përderisa ai i lejuar është plus/minus 59m².
- Parcela është e shtruar me zhavorr dhe shfrytëzohet aktualisht si vend parkim për autobusë nga biznesi "Fidani Tours" si dhe vend parkim për automjete të vogla.
- Parcela ka qasje në rrugën Prizren-Zhur.

1 / 2

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076

Email: info@pak-ks.org
www.pak-ks.org

Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Raporti i vizitës në terren



Fig. 2 Fotografii nga terreni

Agron Iqbal

Zyrtar Kadastral

Nazmije Polloshka

Zyrtare e Zyrës Rajonale

Alban Mazroku

Zyrtar i Zyrës Rajonale

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076

Email: info@pak-ks.org
www.pak-ks.org

Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

2 / 2

**Informatat dhe
Dokumentet e Ofertimit**

Divizioni i Marketingut dhe Tenderit Publik
Tel: +383 (0) 38 500 400 lok.1090, 2059
www.pak-ks.org
Agjencia Kosovare e Privatizimit
Rr. Dritan Hoxha, nr.55
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës